



Aplikim për vizë me qëllim tërheqjen e një fëmije minore gjerman (të palindur)

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit si dhe përmbajuni saktësisht udhëzimeve.

Aplikimet e plotësuara në mënyrë të mangët apo dokumentacioni i paplotë mund të çojnë në refuzimin e aplikimit me pasojë rezervimin e një date të re aplikimi.

Në rastin e aplikimit për vizë Ambasada, si rregull, duhet të përfshijë në procedurë zyrën përkatëse për të huajt në Gjermani. Për këtë arsye procedurat zgjasin zakonisht 8 deri në 12 javë, në raste të veçanta edhe më gjatë. Ndaj lutemi për mirëkuptimin Tuaj për faktin që brenda 12 javëve të para, prej ditës së aplikimit, nuk mund t'u japim përgjigje pyetjeve lidhur me stadin aktual të procedurës.

Përpara se të aplikoni për vizë për tërheqjen e një fëmije minore gjerman (të palindur) lutemi të mbani në konsideratë udhëzimet e mëposhtme:

Për aplikimin ju nevojitet dokumentacioni në formën e përshkruar më poshtë:

1.	Formularë aplikimi për vizë	Në gjermanisht ose anglisht, në dy kopje, të plotësuara në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkruara personalisht.
2.	Tarifa	gratis
3.	Fotografi pashaporte	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhësia 45x35 mm. Lutemi që në secilin prej dy formularëve të aplikimit të ngjisni nga një fotografi, ndërsa fotografinë e tretë silleni me vete si element të veçantë.
Dokumentat e mëposhtme duhen dorëzuar në origjinal, <u>me 2 fotokopje</u>, në momentin e aplikimit		
4.	Pashaporta e udhëtimit	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.
5.	Certifikatë lindjeje e fëmijës	Certifikata e lindjes së fëmijës në origjinal. Certifikatat që nuk janë hartuar në gjuhën gjermane dhe nuk kanë format ndërkombëtar duhet të përkthehen dhe të pajisen me vulën apostille / të legalizimit. Përkthimi gjithashtu duhet të noterizohet. Certifikatat shqiptare me format ndërkombëtar NUK

		kanë nevojë për përkthim por vetëm për Apostile.	
6.	Pashaportë gjermane e fëmijës	Pashaporta gjermane e fëmijës vlen si dëshmi për shtetësinë gjermane.	
7	Vërtetim regjistrimi i fëmijës	Vërtetimi i regjistrimit duhet të jetë lëshuar jo më herët se para 6 muajsh. Nëse fëmija nuk gjendet ende në Gjermani atëherë duhet të paraqitet vërtetimi i regjistrimit të prindit, që jeton në Gjermani.	
8.	Dëshmi e të drejtës së kujdestarisë për fëmijën minore gjerman	Nëse prindërit nuk janë të martuar me njëri-tjetrin atëherë duhet të dëshmohet që prindi që po tërheq fëmijën (babai) ushtron të drejtën e kujdestarisë mbi të. Kjo realizohet përmes paraqitjes së deklaratës gjermane të kujdestarisë.	
9.	Eventualisht dëshmi për atësinë ekzistuese	Nëse babai nuk figuron në certifikatën e lindjes në këtë cilësi dhe prindërit nuk janë të martuar me njëri-tjetrin, atëherë duhet paraqitur edhe një dëshmi tjetër mbi atësinë ekzistuese në formën e njohjes së atësisë me miratimin e nënës ose si një vendim gjykatë për përcaktimin e atësisë.	
10.	Eventualisht certifikatë martese	Nëse prindërit e fëmijës janë të martuar duhet të paraqitet edhe certifikata e martesës. Certifikatat që nuk janë hartuar në gjuhën gjermane dhe nuk kanë format ndërkombëtar duhet të përkthehen dhe të pajisen me vulën apostille / të legalizimit. Përkthimi gjithashtu duhet të noterizohet. Certifikatat shqiptare me format ndërkombëtar NUK kanë nevojë për përkthim por vetëm për Apostile.	
11.	Eventualisht vërtetim shtatzanie dhe dëshmi për shtetësinë gjermane të njërit prej prindërve	Nëse fëmija nuk ka lindur ende në momentin e aplikimit, atëherë duhet të paraqitet një vërtetim mbi shtetësinë ekzistuese (min. java e 12, librezë e shtetësisë, vërtetim nga mjeku, pamje nga eko) si dhe një dëshmi të shtetësisë gjermane të njërit prej prindërve (pashaportë udhëtimi gjermane, kartë identiteti gjermane, letërnjoftim, dëshmi e marrjes së shtetësisë)	
12.	Eventualisht vendim gjykatë për divorc	Nëse nëna e fëmijës ka qenë më parë e martuar dhe babai i fëmijës nuk është bashkëshorti, atëherë duhet të paraqitet vendimi i gjykatës për divorc. Vendimet që nuk janë hartuar në gjuhën gjermane dhe nuk kanë format ndërkombëtar duhet të përkthehen dhe të pajisen me vulën apostille / të legalizimit. Përkthimi gjithashtu duhet të noterizohet	

Në raste të veçanta, gjatë aplikimit apo procedurës së vizës, mund të kërkohen dokumenta të caktuar të papërmendura më sipër.

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.